



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë , më 27.08.2025

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-SHERBIME

ME
OBJEKT

“SHERBIME TE MIREMBAJTJES SE REZERVUAREVE E LIQENEVE NEN ADMINISTRIMIN E BASHKISE KRUJE, (REHABILITIMI I PRITES LUMORE MURQINE FUSHE KRUJE DHE REHABILITIMI DHE PASTRIMI I PERROIT TE KRESHNICES ZALLE-FUSHE KRUJE)”

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

I mbajtur sot me **date 27.08.2025** , ne Kruje, nga ana e Njesise se Prokurimit te ngritur me urdherin **nr.329date 25.08.2025** , me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar” , me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Sherbime te mirembajtjes se rezervuareve e liqeneve nen administrimin e Bashkise Kruje, (Rehabilitimi i prites lumore Murqine Fushe Kruje dhe Rehabilitimi dhe pastrimi i perroit te Kreshnices Zalle-Fushe Kruje)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Sherbime per riparimin dhe mirembajtjen e rezervuareve /(50514200-3)

VLERA E FONDIT LIMIT: 3’583’333 (tre million e peseqind e tetedhjetë e tre mije e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh .

BURIMI I FINACIMIT:Transferta Specifike.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kruje** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (NE VLEREN PREJ 2 % TE SHUMES SE FONDIT LIMIT)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2025 të njohura nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së takses vendore 2025 për secilin operator)*

Shenim-Per të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.10 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2025 të leshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së takses vendore 2025 për secilin operator).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Krujës, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetencën të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kështevave të pagimit të taksës dhe afatet e

kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.2-a)Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10)

2.1.2-b):Ofertuesi duhet të paraqesi licensen profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës e vlefshme sipas modelit të leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktura/MIE.

- **Shoqëria ofertuese duhet të paraqesi licensen e shoqërisë të vlefshme për pikat dhe klasifikimin si më poshtë vijon:**
- **NP-7/A** Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje

Shenim-Licensa duhet të jetë leshuar në përputhje me kërkesat e VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar me VKM nr. 92 datë 19.02.2014.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktura, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM Nr.42, datë 16.01.2008 ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve/sherbimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas	Zërat e punimeve/sherbimeve	Niveli i klasifikimit i	Vlera e punimeve që
---------------------	-------------------------------	-----------------------------	-------------------------	---------------------

	legjislacionit të fushës	që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	kërkuar për kategorinë respektive	parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP.7	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje	Kjo pikë kategorie është vendosur për kryerjen e punimeve/sherbimeve të mbrojtjes lumore	A	Brenda vleres së kufirit të parashikuar në VKM nr 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

2.2.a- Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklaramit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2022,2023,2024) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te kontrates qe prokurohet përkatësisht: **1'433'333(njemilion e katerqind e tridhjetë e tre mije e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.**

Shenim-Pika 2.2-a) plotësohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe **nenin 43.2.c dhe 55.4** të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar si më sipër konsiderohet tregues i rëndësishëm për kapacitetin financiar të Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marrë në analizë edhe faktin se vlera e fondit limit është e nën kufirin e ulët monetar dhe iu jep mundësinë ndër të tjera e dhe operatorëve ekonomik të vegjël dhe të mesëm të kenë akses në oferte.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", gjithashtu është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

Teresia e kriterëve që i perkasin kapacitetit teknik si pjese integrale e kriterëve të vecanta është hartuar nga Sektori i Bordit të Kullimit pranë Bashkisë Krujë dhe janë percjelle në NJ.P.P me shkresën **nr. 6448.prot date 25.08.2025**

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1-Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a)Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e shërbimeve të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me një vlerë sa 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht në shumën **716'666(shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.**

Për të vërtetuar këtë Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin:

- Kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme, është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kontratës si dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruara nga të dyja palët.
- Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “ Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4. “*në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën*” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së

përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën maksimale 20% të vlerës së fondit limit, që është në vlerën kufi maksimale e përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 20% të fondit limit.

Vlera në kufirin e përcaktuar në VKM nr 285 datë 19.05.2021, është përcaktuese dhe objektive, si dhe garanton AK (Bashkinë e Krujës), se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësie si dhe të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

3.-Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, staf inxhinierik si më poshtë për të cilin duhet të paraqesi kontratë pune të vlefshme (me afat vlefshmërie brenda afatit të realizimit të shërbimit për këtë objekt), diploma dhe CV.

• Inxhinier Ndertimi /hidroteknik 1

Shenim- Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.10, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës,

për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të **paktën 07 persona** është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimeve si dhe VKM për kohën e punës në muaj për punonjës dhe analizave teknike të kostos së shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane për çdo zonë të preventivit respektiv. Po t'i referohemi preventivit, VKM, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë i është plotësuar i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3-6-Personeli mbeshtetes i kualifikuar dhe teknik

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 1 (një) punonjës manovratorë të mjeteve/makinerive të rënda (specifikisht një për manovrator për eskavator). Për çdo profil punonjësi teknik si më sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (përgjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse sipas modaliteteve të **urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019**

Shënim- Për të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.10, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve/shërbimeve sipas grafikut të tyre, që është përlogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Gjithashtu për profilin e manovratorëve është marrë në konsideratë direkte natyra e zerit të punimeve përkatëse të cilët mund të zbatohen vetëm nëpërmjet proceseve të mjeteve e makinerive të vecanta ose të rënda të cilat janë kërkesë funksionale e realizimit të zerave të punimeve.

2.3.4.-Personeli dhe fuqia punëtore:

Kandidati/ofertues duhet te vertetoje se disponon numrin e nevojshem te punonjesve per ekzekutimin e kontrates dhe per te provuar kete kusht duhet te kete **një punësim mesatar per muajin fundit te deklarimit sipas legjislacionit fiskal ne fuqi , duke nisur nga data e dorezimit te ofertave, i te pakten 07 (shtate) personave duke përfshirë stafin e përhershëm te provuar me :**

- Vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Qarkut ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te qarkut perkates .

ose

- Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 025) sipas formatit elektronik ne perputhje me VKM nr 922 date 29.12.2014’’**Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike’’**

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.10 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të **paktën 07 persona** është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimeve si dhe VKM per kohen e punes ne muaj per punonjes dhe analizave teknike te koston se shërbimit te pastrimit dhe largimit te mbetjeve urbane per cdo ze te preventivit respektiv. Po t’i referohemi preventivit, VKM, relacionit, matjeve përkatëse që jane bërë i është plotësuar i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale,

personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithëka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje **per periudhen e fundit te deklarimit sipas legjislacionit fiskal ne fuqi**, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

6.-Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

I.MAKINERI	Njesia	Sasia	Pronesia
Automjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton.	copë	2	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir 0.5 m3.	copë	1	Pronësi ose me qera
II.PAJISJE			
Jelekë fosforeshentë.	copë	7	Pronësi ose me qera
Kokore për punonjësit.	copë	7	Pronësi ose me qera
Kuti e ndihmës së shpejtë.	copë	1	Pronësi ose me qera

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).*
- Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10.pika B (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kruje. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).*

Shenim- Per të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, **sipas shtojcës nr.10** , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke ju referuar zerave të shërbimit sipas specifikimeve teknike, sipas grafikut të detajuar dhe kohëzgjatjes së shërbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjës për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zërat e shërbimit.

Nga ana e autoritetit kontraktor vendosja e këtij kriteri është në përpjetstim më natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës si dhe përcaktimeve ligjore në Kodin Civil.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në analiza të mbeshetur ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin

dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore ne fuqi per disiplinimin e punimeve te ndertimit. Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

Argumentimi i specifikimeve teknike

- Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga subjekti i licensuar qe ka hartuar edhe projektin perkates te zbatimit duke qene elemente perberes te tij. Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e ligjit te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore". Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”
- Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.
- **Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 629 date 15.07.2015 ''Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre'' i ndryshuar.**

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

PER NJESINE E PROKURIMIT PUBLIK